

RELACION
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 15/2019 “PËR
NXITJEN E PUNËSIMIT””, I NDRYSHUAR

**I.QËLLIMI PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Projektligji “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”*”, i ndryshuar, ka për qëllim përditësimin dhe forcimin e kuadrit ligjor për politikat e punësimit, me synim rritjen e punësueshmërisë së forcës së punës, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike të punësimit dhe zgjerimin e instrumenteve aktive të tregut të punës.

Projektligji kontribuon në përmbushjen e angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian, veçanërisht në lidhje me Kapitullin 2 “*Lëvizja e lirë e punëtorëve*” dhe Kapitullin 19 “*Politika sociale dhe punësimi*”. Nëpërmjet krijimit të bazës ligjore për funksionimin e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Punësimit (EURES), forcimit të shërbimeve të punësimit, zhvillimit të instrumenteve digjitale dhe zgjerimit të masave aktive të tregut të punës, projektligji synon përafrimin gradual të kuadrit kombëtar me standardet e *acquis* të Bashkimit Evropian.

Nëpërmjet ndërhyrjeve të propozuara synohet krijimi i një qasjeje më të integruar dhe efektive për mbështetjen e punëkërkuesve, punëdhënësve dhe grupeve të veçanta, përfshirë të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, migrantët e kthyer dhe kategoritë e tjera që përballen me barriera në aksesin në tregun e punës. Gjithashtu, ndryshimet synojnë përshtatjen e legjislacionit kombëtar me zhvillimet e tregut të punës, modernizimin dhe digjitalizimin e shërbimeve të punësimit, si dhe forcimin e bashkëpunimit me subjektet e tregut të punës.

Relacion shpjegues për projektligjin “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”*”, i ndryshuar

Projektligji krijon bazën ligjore për zhvillimin e instrumenteve të reja, si:

- mekanizmat e mbështetjes së Garancisë Rinore;
- Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Punësimit (EURES);
- Observatori i Informacionit të Tregut të Punës dhe Aftësive;
- Pasaporta Digjitale e Punësimit dhe Aftësive.

Këto ndërhyrje synojnë kalimin nga një model tradicional i ofrimit të shërbimeve drejt një modeli proaktiv, të orientuar nga nevojat e individit dhe kërkesat reale të tregut të punës.

Projektligji kontribuon gjithashtu në zbatimin e Objektivit 8 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDG 8), që synon promovimin e rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë dhe produktiv, si dhe punës së denjë për të gjithë.

II.VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Programi i Qeverisë i kushton një rëndësi të veçantë rritjes së punësimit, zhvillimit të aftësive dhe përmirësimit të cilësisë së kapitalit njerëzor, në përputhje me objektivat strategjike të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, si dhe me orientimet e politikave të Bashkimit Evropian në fushën e punësimit dhe aftësive.

Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj janë në përputhje me:

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE);
- Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030;
- Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore;
- angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, veçanërisht në Kapitullin 2 “*Lëvizja e lirë e punëtorëve*” dhe Kapitullin 19 “*Politika Sociale dhe Punësimi*”.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 përcakton si prioritet zhvillimin e politikave aktive të tregut të punës, përmirësimin e

shërbimeve të punësimit, forcimin e lidhjes ndërmjet arsimit dhe tregut të punës, si dhe zhvillimin e sistemeve të informacionit të bazuara në evidencë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, në zbatim të orientimeve të programit të Qeverisë, ka hartuar këtë projektligj, i cila fokusohet në çështjet më kritike të punësimit të cilat kërkojnë të përmirësohen apo të jenë pjesë e ligjit. Projektligji synon të përditësojë dhe të forcojë kuadrin ligjor të politikave të punësimit, në përputhje me zhvillimet e tregut të punës, prioritetet kombëtare për punësimin dhe aftësitë, procesin e integrimit evropian dhe nevojën për digjitalizimin e shërbimeve publike. Ndërhyrja rregullatore adreson mangësitë e konstatuara gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, qartëson konceptet dhe përgjegjësitë institucionale dhe krijon bazën ligjore për mekanizma dhe instrumente të reja të tregut të punës.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit.

Ky projektligj u gjenerua në sistemin e mbivendosjes ligjore dhe pas kërimit rezulton se nuk ka mbivendosje ligjore.

Akti i propozuar nuk ka për qëllim ndërmarrjen e proceseve të derregullimit dhe nuk sjell thjeshtim, reduktim apo eliminim të procedurave administrative ekzistuese.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”*”, i ndryshuar, është hartuar në përputhje me parimet dhe standardet.

Relacion shpjegues për projektligjin “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”*”, i ndryshuar

e Bashkimit Evropian në fushën e punësimit dhe lëvizjes së lirë të punëtorëve, duke kontribuar në përafrimin gradual të legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire*.

Në kuadër të Kapitullit 19 *“Politika Sociale dhe Punësimi”*, projektligji synon forcimin e politikave aktive të tregut të punës, përmirësimin e shërbimeve të punësimit, mbështetjen e kategorive në disavantazh dhe rritjen e efektivitetit të masave për integrimin në tregun e punës.

Në kuadër të Kapitullit 2 *“Lëvizja e Lirë e Punëtorëve”*, projektligji është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) 2016/589 për Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Punësimit (EURES), nëpërmjet krijimit të bazës ligjore për ngritjen e strukturave kombëtare të EURES-it, përfshirë Zyrën Kombëtare Koordinuese dhe Sistemin Kombëtar të Pranimit të Anëtarëve dhe Partnerëve EURES, si dhe përgatitjen për shkëmbimin e informacionit mbi vendet e lira të punës dhe punëkërkuesit.

Në tërësi, projektligji kontribuon në përmbushjen e angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian, veçanërisht në drejtim të përafrimit të legjislacionit dhe forcimit të kapaciteteve institucionale në fushën e punësimit dhe mobilitetit të punëtorëve.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”*”, i ndryshuar, përbëhet nga 18 nene, të cilat në mënyrë të përmbledhur parashikojnë, sa vijon:

Neni 1 parashikon ndryshime dhe shtesa në nenin 3 të ligjit nr. 15/2019 *“Për nxitjen e punësimit”*, i ndryshuar, me qëllim përditësimin e terminologjisë ligjore, përshtatjen e saj me zhvillimet e tregut të punës dhe krijimin e bazës ligjore për instrumente të reja në fushën e politikave të punësimit, arsimit dhe formimit profesional dual, digjitalizimit të shërbimeve të punësimit dhe procesit të integrimit evropian.

Nëpërmjet këtyre ndryshimeve zgjerohen kategoritë e përfshira në kuadrin ligjor të punësimit, duke harmonizuar grupmoshën e të rinjve me kuadrin e Garancisë Rinore, përfshirë të rinjtë deri në moshën 29 vjeç. Gjithashtu, përfshihet për

Relacion shpjegues për projektligjin *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”*”, i ndryshuar

herë të parë kategoria e “nxënësit punëmarrës”, në mbështetje të zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional në formën duale, ku nxënësit kombinojnë mësimin teorik me praktikën profesionale pranë subjekteve pritëse.

Dispozita zgjeron konceptin e punëkërkuesit duke përfshirë edhe shtetasit shqiptarë me vendbanim jashtë Republikës së Shqipërisë, duke krijuar mundësi më të mëdha për përfshirjen e diasporës në shërbimet dhe programet e punësimit. Gjithashtu, riformulohen konceptet e “punëkërkuesit të papunë të regjistruar” dhe “punësimit të përshtatshëm”, me qëllim sigurimin e një qasjeje më të personalizuar në ndërmjetësimin për punësim dhe përshtatjen e shërbimeve me nevojat individuale të punëkërkuesve.

Në këtë nen përcaktohen gjithashtu koncepte të reja si “subjektet e tregut të punës”, “Observatori i Informacionit të Tregut të Punës dhe Aftësive”, si dhe mekanizmat që lidhen me pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Punësimit (EURES), përfshirë Sistemin e Pranimit të Anëtarëve dhe Partnerëve EURES dhe Kanalin e Vetëm të Koordinuar. Këto ndryshime krijojnë bazën ligjore për forcimin e mobilitetit të fuqisë punëtore, përmirësimin e shkëmbimit të informacionit mbi tregun e punës dhe përafrimin gradual me mekanizmat evropianë në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.

Neni 2 parashikon ndryshime dhe shtesa në nenin 4 të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, me qëllim zgjerimin e kategorive përfituese të shërbimeve të punësimit, harmonizimin e terminologjisë me legjislacionin në fuqi për të huajt dhe krijimin e bazës ligjore për përfshirjen më të gjerë të subjekteve të tregut të punës në zbatimin e politikave aktive të punësimit.

Nëpërmjet këtyre ndryshimeve përcaktohet se të drejtën për të përfituar nga shërbimet e ofruara nga strukturat publike të punësimit e kanë edhe shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi që hyjnë, qëndrojnë ose synojnë të qëndrojnë ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllime punësimi, në përputhje me legjislacionin për të huajt. Ky ndryshim synon të mbështesë integritimin e fuqisë punëtore të huaj në tregun shqiptar të punës, duke garantuar akses në informacion, orientim profesional, këshillim dhe ndërmjetësim për punësim, si dhe duke kontribuar në reduktimin e informalitetit.

Gjithashtu, dispozita harmonizon terminologjinë ligjore duke zëvendësuar termin “leje pune” me termin “leje unike”, në përputhje me legjislacionin aktual për të huajt. Për më tepër, përcaktohet se punëdhënësit dhe subjektet e tregut të punës që zbatojnë programe aktive të tregut të punës konsiderohen përfitues të

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit””, i ndryshuar

masave mbështetëse të parashikuara nga ligji, duke reflektuar rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të aktorëve publikë dhe privatë në zbatimin e politikave aktive të punësimit.

Neni 3 parashikon ndryshime dhe shtesa në nenin 7 të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, me qëllim modernizimin e shërbimeve të punësimit, zgjerimin e instrumenteve në dispozicion të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, si dhe krijimin e bazës ligjore për përfshirjen e subjekteve të tregut të punës në ofrimin dhe zbatimin e këtyre shërbimeve.

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara, qartësohet dhe zgjerohet përmbajtja e shërbimeve të punësimit, të cilat nuk kufizohen vetëm në ndërmjetësimin për punësim, por përfshijnë edhe orientimin për karrierën, këshillimin për punësim, vlerësimin e aftësive, referimin drejt programeve të formimit profesional dhe mbështetjen për përfitimin nga programet aktive të tregut të punës.

Dispozita ruan parimin e ofrimit pa pagesë të shërbimeve bazë të punësimit për punëkërkuesit dhe punëdhënësit, duke krijuar njëkohësisht mundësinë që institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë të ofrojë shërbime të specializuara për punëdhënësit kundrejt tarifës, në përgjigje të nevojave të reja të tregut të punës për shërbime më të avancuara të rekrutimit dhe identifikimit të fuqisë punëtore.

Gjithashtu, krijohet mundësia e kontraktimit të subjekteve të tregut të punës për ofrimin e shërbimeve të specializuara ndaj grupeve të veçanta dhe në territore specifike, me qëllim rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve për kategoritë që kanë nevojë për mbështetje më intensive, si të rinjtë NEET, personat me aftësi të kufizuara, migrantët e kthyer dhe kategori të tjera vulnerabël. Ndryshimet e tjera kanë karakter harmonizues dhe synojnë përshtatjen e dispozitave ekzistuese me mekanizmat dhe instrumentet e reja të propozuara.

Neni 4 parashikon shtimin e nenit të ri 7/1 në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, me qëllim krijimin e një kuadri të unifikuar ligjor për rregullimin e procedurave që lidhen me regjistrimin, verifikimin, pezullimin, çregjistrimin, heqjen dhe rifitimin e statusit të punëkërkuesit dhe punëkërkuesit të papunë.

Kjo dispozitë synon konsolidimin e kuadrit ligjor që rregullon statusin e punëkërkuesit, duke integruar në ligjin për nxitjen e punësimit elementët kryesorë që lidhen me administrimin e këtij statusi dhe duke shmangur fragmentarizimin e rregullimit ligjor të parashikuar aktualisht në akte të veçanta.

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit””, i ndryshuar

Nëpërmjet këtij ndryshimi krijohet një procedurë më e unifikuar, transparente dhe funksionale për administrimin e marrëdhënies ndërmjet punëkërkuessit dhe strukturave përgjegjëse të punësimit.

Dispozita përcakton se këto procedura administrohen nga strukturat përgjegjëse të punësimit dhe qartëson detyrimet e punëkërkuessit të regjistruar, përfshirë detyrimin për të dhënë informacion të saktë, për të njoftuar ndryshimet në rrethanat personale dhe profesionale, si dhe për të marrë pjesë në masat e aktivizimit të dakordësuara. Gjithashtu, përcaktohen rastet kur statusi mund të pezullohet ose hiqet, si dhe parashikohet që kriteret dhe procedurat e hollësishme të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5 parashikon ndryshime dhe shtesa në nenin 11 të ligjit nr. 15/2019 “*Për nxitjen e punësimit*”, i ndryshuar, me qëllim zgjerimin e fushës së veprimit të programeve aktive të tregut të punës, forcimin e ndërhyrjeve parandaluese ndaj papunësisë, mbështetjen e procesit të riintegritimit të migrantëve të kthyer dhe krijimin e bazës ligjore për përfshirjen e subjekteve të tregut të punës në zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit.

Nëpërmjet këtyre ndryshimeve zgjerohet kategoria e përfituesve të programeve aktive të tregut të punës, duke përfshirë edhe personat e punësuar që rrezikojnë humbjen e vendit të punës si rezultat i ndryshimeve ekonomike, teknologjike, ristrukturimit të ndërmarrjeve ose faktorëve të tjerë që ndikojnë në qëndrueshmërinë e marrëdhënies së punës. Kjo qasje synon të mundësojë ndërhyrje në faza të hershme, përmes orientimit, këshillimit, riaftësisimit dhe masave të tjera mbështetëse, përpara kalimit të personave në papunësi.

Gjithashtu, shtohen kategori të reja të shpenzimeve të pranueshme, duke përfshirë kostot e lidhura drejtpërdrejt me zbatimin e programeve nga subjektet e tregut të punës, si dhe shpenzimet që lidhen me zhvendosjen ose riintegrimin e migrantëve të kthyer. Këto ndryshime synojnë të krijojnë mundësi për programe më gjithëpërfshirëse dhe më të përshtatura me nevojat e grupeve të ndryshme përfituese. Dispozita qartëson gjithashtu se programet e nxitjes së punësimit administrohen dhe zbatohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, i cili mund të kontraktojë subjekte të tregut të punës për realizimin e tyre, duke forcuar modelin e bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe aktorëve të tjerë të tregut të punës.

Neni 6 parashikon ndryshime dhe shtesa në nenin 11/1 të ligjit nr. 15/2019 “*Për nxitjen e punësimit*”, i ndryshuar, me qëllim forcimin e bazës ligjore dhe institucionale të Skemës së Garancisë Rinore dhe garantimin e një zbatimi më të

Relacion shpjegues për projektligjin “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”*”, i ndryshuar

koordinuar të saj. Nëpërmjet këtij ndryshimi zgjerohet objekti i Skemës së Garancisë Rinore, duke reflektuar faktin se kjo skemë nuk mbështetet vetëm në programet e punësimit, por përfshin një sistem më të gjerë shërbimesh, si shërbimet e punësimit, orientimin profesional, këshillimin individual, profilizimin, formimin profesional dhe programet aktive të tregut të punës.

Gjithashtu, përcaktohet baza ligjore për Planin e Zbatimit të Skemës së Garancisë Rinore, duke përcaktuar elementët kryesorë të tij, rolin e institucioneve përgjegjëse dhe mekanizmat e koordinimit ndërmjet institucioneve të fushës së arsimit, punësimit dhe mbrojtjes sociale. Parashikohet që Plani i Zbatimit dhe procedurat për realizimin e tij të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7 parashikon shtimin e nenit të ri 11/2 “Mekanizmi i Partneriteteve Vendore”, me qëllim krijimin e një baze të posaçme ligjore për ngritjen e mekanizmave bashkëpunues në nivel vendor në mbështetje të zbatimit të Skemës së Garancisë Rinore. Dispozita synon forcimin e qasjes ndër-institucionale për identifikimin, kontaktimin dhe aktivizimin e të rinjve që nuk janë në punësim, arsim ose formim profesional (NEET), të cilët përballen me rrezik më të lartë përjashtimi nga tregu i punës dhe sistemet e mbështetjes.

Nëpërmjet partneriteteve vendore krijohet mundësia për bashkëpunim ndërmjet strukturave të punësimit, institucioneve arsimore, strukturave të mbrojtjes sociale, njërive të vetëqeverisjes vendore, partnerëve socialë dhe aktorëve të tjerë komunitarë, me qëllim zhvillimin e ndërhyrjeve të personalizuara për të rinjtë. Rregullat për organizimin, funksionimin dhe financimin e këtyre mekanizmave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8 parashikon ndryshime në nenin 14 të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, me qëllim zgjerimin e bashkëpunimit të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë me aktorët e tregut të punës në zbatimin e politikave dhe shërbimeve të punësimit. Nëpërmjet këtij ndryshimi zgjerohet kuadri i bashkëpunimit institucional, duke përfshirë jo vetëm punëdhënësit, por edhe subjektet e tjera të tregut të punës, si organizata jofitimprurëse, institucione formimi, organizata ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë që kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve dhe zbatimin e programeve të punësimit.

Neni 9 parashikon shtimin e nenit të ri 14/1 “Zyra Kombëtare Koordinuese e EURES-it”, me qëllim krijimin e bazës ligjore për organizimin dhe funksionimin e mekanizmave kombëtarë të nevojshëm për pjesëmarrjen graduale të Republikës së Shqipërisë në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit””, i ndryshuar

Punësimi (EURES), në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian dhe Kapitulli 2 “Lëvizja e lirë e punëtorëve”.

Dispozita përcakton institucionin përgjegjës për ushtrimin e funksionit të Zyrës Kombëtare Koordinuese të EURES-it, kompetencat e saj për koordinimin e rrjetit kombëtar, administrimin e Sistemit Kombëtar të Pranimi të Anëtarëve dhe Partnerëve EURES, si dhe mbikëqyrjen e përmbushjes së standardeve të kërkuara për pjesëmarrjen në rrjet. Gjithashtu, përcaktohen rregullat për transmetimin e vendeve të lira të punës dhe profileve të punëkërkesve nëpërmjet Kanalit të Vetëm të Koordinuar, duke garantuar respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Dispozita krijon gjithashtu bazën për bashkëpunimin me institucionet homologe evropiane dhe mbështetjen e punëtorëve ndërkufitarë.

Neni 10 parashikon shtesë në nenin 15 të ligjit nr. 15/2019 “*Për nxitjen e punësimi*”, i ndryshuar, me qëllim zgjerimin e rolit këshillimor të Këshillit Kombëtar të Punësimi dhe Aftësive në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Punësimi (EURES). Nëpërmjet kësaj shtese, Këshilli Kombëtar i Punësimi dhe Aftësive pajiset me kompetencë për të dhënë mendime edhe për çështjet që lidhen me mekanizmat kombëtarë të EURES-it, duke garantuar përfshirjen e partnerëve socialë dhe aktorëve kryesorë të tregut të punës në proceset konsultative që lidhen me mobilitetin e fuqisë punëtore dhe integrimin gradual të Shqipërisë në tregun evropian të punës.

Neni 11 parashikon shtesa në nenin 16 të ligjit nr. 15/2019 “*Për nxitjen e punësimi*”, i ndryshuar, me qëllim krijimin e bazës ligjore për funksionimin e Observatorit të Tregut të Punës dhe Aftësive si mekanizëm kombëtar i integruar për mbledhjen, shkëmbimin, përpunimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi tregun e punës dhe zhvillimin e aftësive. Krijimi i këtij mekanizmi synon të adresojë nevojën për një sistem më të konsoliduar dhe të bazuar në të dhëna për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave të punësimi dhe zhvillimit të aftësive. Nëpërmjet Observatorit synohet përmirësimi i cilësisë dhe disponueshmërisë së informacionit mbi kërkesën dhe ofertën për punë, nevojat e tregut për aftësi, tendencat e punësimi, profesionet në zhvillim dhe boshllëqet e aftësive.

Dispozita parashikon detyrimin e subjekteve të tregut të punës që disponojnë të dhëna relevante për tregun e punës dhe aftësitë që t’i shkëmbejnë këto të dhëna në mënyrë elektronike nëpërmjet bazës së integruar të të dhënave të administruar nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë. Ky

Relacion shpjegues për projektligjin “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimi”*”, i ndryshuar

rregullim synon krijimin e një ekosistemi të përbashkët informacioni, ku të dhënat e gjeneruara nga institucionet publike dhe aktorët e tjerë të tregut të punës të përdoren për analiza më të sakta dhe për planifikim më efektiv të ndërhyrjeve publike. Administrimi i bazës së integruar të të dhënave nga një institucion i vetëm përgjegjës garanton koordinimin institucional, standardizimin e informacionit dhe përdorimin e tij në funksion të politikëbërjes së bazuar në evidencë. Procesi i mbledhjes, shkëmbimit dhe përpunimit të të dhënave do të realizohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit. Gjithashtu, dispozita parashikon që të dhënat që do të përfshihen në Observator, institucionet, mënyra e ndërveprimit me bazat e tjera shtetërore të të dhënave dhe nivelet e aksesit do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12 parashikon shtimin e nenit të ri 16/1 në ligjin nr. 15/2019 *“Për nxitjen e punësimit”*, i ndryshuar, me qëllim krijimin e Pasaportës Digjitale të Punësimit dhe Aftësive si instrument kombëtar për dokumentimin, administrimin dhe verifikimin e informacionit mbi historikun e punësimit, profesionin, kualifikimet, aftësitë dhe përvojën profesionale të individit. Krijimi i këtij instrumenti synon të mbështesë procesin e digjitalizimit të shërbimeve të punësimit dhe të krijojë një burim unik, të besueshëm dhe të aksesueshëm informacioni për profilin profesional të individit. Pasaporta Digjitale do të mundësojë integrimin e të dhënave që lidhen me marrëdhëniet e punës, periudhat e punësimit, profesionet e ushtruara, kualifikimet dhe aftësitë e fituara gjatë karrierës profesionale.

Nëpërmjet këtij mekanizmi synohet lehtësimi i procesit të ndërmjetësimit në punësim, përmirësimi i profilizimit të punëkërkuësve, identifikimi më i saktë i nevojave për aftësi dhe orientimi i individëve drejt mundësive të punësimit dhe formimit profesional. Gjithashtu, ky instrument do të reduktojë barrën administrative për qytetarët dhe institucionet, duke shmangur kërkesat e përsëritura për dokumentacion fizik dhe duke mundësuar verifikimin elektronik të informacionit. Dispozita përcakton se Pasaporta Digjitale e Punësimit dhe Aftësive administrohet nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë përmes një platforme të integruar me bazat shtetërore të të dhënave dhe përdoret për ofrimin, administrimin dhe verifikimin e shërbimeve dhe programeve të punësimit dhe aftësive. Përpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave do të realizohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe shërbimet digjitale, ndërsa rregullat për funksionimin, përmbajtjen, ndërveprimin dhe aksesimin e Pasaportës Digjitale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13 parashikon ndryshime në nenin 18 të ligjit nr. 15/2019 “*Për nxitjen e punësimit*”, i ndryshuar, me qëllim harmonizimin e terminologjisë ligjore dhe përshtatjen e dispozitës me qasjen e re të politikave aktive të tregut të punës. Nëpërmjet këtij ndryshimi shfuqizohet një dispozitë që nuk paraqet më nevojë rregulluese, duke përmirësuar koherencën dhe qartësinë e kuadrit ligjor. Gjithashtu, riformulohet terminologjia lidhur me përfitimin nga programet e tregut të punës, duke kaluar nga koncepti i programeve të kufizuara të nxitjes së punësimit dhe kualifikimit drejt konceptit më të gjerë të programeve aktive të tregut të punës. Ky ndryshim synon të sigurojë që masat e mbështetjes të lidhen drejtpërdrejt me mundësitë konkrete të punësimit dhe vendet e punës të ofruara, duke forcuar orientimin e politikave aktive drejt rezultateve të matshme dhe integritit të qëndrueshëm të individëve në tregun e punës.

Neni 14 parashikon ndryshime dhe shtesa në nenin 19 të ligjit nr. 15/2019 “*Për nxitjen e punësimit*”, i ndryshuar, me qëllim rritjen e transparencës në tregun e punës, përmirësimin e informacionit mbi kërkesën dhe ofertën për punë, forcimin e ndërmjetësimit në punësim dhe krijimin e mekanizmave për ndërhyrje të hershme ndaj personave që humbasin vendin e punës. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve vendoset detyrimi i punëdhënësve për të deklaruar pranë institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë vendet e lira të paguara të punës, duke mundësuar një lidhje më efektive ndërmjet kërkesës dhe ofertës për punë. Për herë të parë parashikohet edhe detyrimi për publikimin e intervalit të pagës për pozicionet e lira, me qëllim rritjen e transparencës në proceset e rekrutimit dhe krijimin e kushteve për vendimmarrje më të informuar nga punëkërkuesit.

Gjithashtu, dispozita vendos detyrimin e punëdhënësve për deklarimin dhe përditësimin e të dhënave mbi marrëdhëniet e punës së punonjësve, duke mbështetur funksionimin e sistemeve të informacionit të tregut të punës, Observatorit të Tregut të Punës dhe Aftësive dhe Pasaportës Digjitale të Punësimit dhe Aftësive. Në rastet e përfundimit të marrëdhënies së punës, parashikohet detyrimi për njoftimin elektronik të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, duke krijuar mundësinë për ndërhyrje të hershme përmes ofrimit të shërbimeve të këshillimit, orientimit profesional, ndërmjetësimit dhe programeve aktive të tregut të punës.

Neni 15 parashikon ndryshime në nenin 22 të ligjit nr. 15/2019 “*Për nxitjen e punësimit*”, i ndryshuar, me qëllim qartësimin e kompetencave institucionale për konstatimin dhe sanksionimin e kundërvajtjeve administrative që lidhen me detyrimet e punëdhënësve sipas këtij ligji. Nëpërmjet këtij ndryshimi përcaktohet administrata tatimore si autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe

zbatimin e masave administrative për shkeljet që lidhen me detyrimet e parashikuara në nenin 19 dhe nenin 20 të ligjit, në përputhje me legjislacionin për procedurat tatimore. Ky rregullim synon të shmangë paqartësitë institucionale, të forcojë mekanizmat e kontrollit dhe të sigurojë zbatim më efektiv të detyrimeve të vendosura ndaj punëdhënësve.

Neni 16 parashikon ndryshime në nenin 24 të ligjit nr. 15/2019 *“Për nxitjen e punësimit”*, i ndryshuar, me qëllim harmonizimin e dispozitave që lidhen me nxjerrjen e akteve nënligjore me ndryshimet e reja të propozuara në projektligj. Ky ndryshim synon të sigurojë bazën e nevojshme ligjore për miratimin e akteve zbatuese që do të rregullojnë procedurat, mekanizmat dhe instrumentet e reja të parashikuara në ligj, duke garantuar zbatimin efektiv të kuadrit të përditësuar rregullator.

Neni 17 parashikon ndryshime në nenin 25 të ligjit nr. 15/2019 *“Për nxitjen e punësimit”*, i ndryshuar, me qëllim konsolidimin e kuadrit ligjor që rregullon shërbimet e punësimit dhe statusin e punëkërkuesit. Nëpërmjet këtij ndryshimi parashikohet shfuqizimi i ligjit nr. 146/2015 *“Për punëkërkuesit”*, pasi dispozitat kryesore që lidhen me regjistrimin, verifikimin, pezullimin, çregjistrimin, heqjen dhe rifitimin e statusit të punëkërkuesit dhe punëkërkuesit të papunë integrohen në ligjin nr. 15/2019. Ky konsolidim synon krijimin e një kuadri më të unifikuar ligjor, eliminimin e mbivendosjeve normative, rritjen e sigurisë juridike dhe përmirësimin e zbatimit praktik të politikave të punësimit.

Neni 18 parashikon dispozita tranzitore për zbatimin gradual të detyrimeve dhe mekanizmave të rinj të parashikuar në projektligj, me fokus të veçantë në punësimin e personave që u përkasin grupeve të veçanta dhe funksionalizimin gradual të mekanizmave kombëtarë të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Punësimit (EURES). Dispozita përcakton një regjim tranzitor për zbatimin e kuotave të punësimit për grupet e veçanta, duke parashikuar detyrimet graduale të punëdhënësve dhe mekanizmin alternativ të kontributit në Fondin Social të Punësimit në rast mosplotësimi të kuotave. Gjithashtu, përcaktohet kalimi në zbatimin e plotë të këtyre detyrimeve pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në lidhje me EURES-in, dispozita përcakton fazat e ngritjes dhe funksionimit të strukturave kombëtare, përfshirë Zyrën Kombëtare Koordinuese dhe Sistemin Kombëtar të Pranimi të Anëtarëve dhe Partnerëve EURES. Parashikohet që këto struktura të krijohen dhe të përgatiten institucionalisht përpara pjesëmarrjes së plotë në rrjet, ndërsa shkëmbimi i plotë i të dhënave dhe ndërveprimi me sistemet evropiane do të realizohet në përputhje me kushtet dhe detyrimet që

rrjedhin nga acquis i Bashkimit Evropian dhe Rregullorja (BE) 2016/589 për EURES. Këto dispozita tranzitore synojnë të sigurojnë një kalim gradual dhe të kontrolluar drejt zbatimit të plotë të kërkesave të reja ligjore, duke i dhënë institucioneve dhe aktorëve të tregut kohën e nevojshme për përshtatjen institucionale, teknike dhe administrative.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e këtij akti janë Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Inspektoriati Qendror i Punës.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin nr.4/2025 të Kryeministrit *“Për ngritjen e grupit ndërinstitutional të punës për ndryshimin e ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit””* me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Inspektoriatit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Hartimi i projektligjit është mbështetur nga asistenca teknike e ofruar nga UNDP, projekti *“Aftësi për punësim”* dhe GIZ/SANECA, në kuadër të kërkesave të kapitullit 2 *“Lëvizja e lirë e punëtorëve”*.

Projektligji dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Këshillit Konsultativ ndërmjet Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe INSTAT.

Relation shpjegues për projektligjin *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit””*, i ndryshuar

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Financimi do të bëhet nga Buxheti i Shtetit për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, sipas parashikimeve buxhetore afatmesme dhe afatgjata në PBA në programin buxhetor 10550 “*Tregu i Punës*”.

MINISTËR
Delina Ibrahimaj

The image shows a circular official stamp of the Ministry of Economy and Innovation (Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit) in Tirane. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRI", "MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT", and "TIRANË". A large, stylized signature is written over the stamp.